



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 116 Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 31/08/2021

**VENDIM**  
Nr.31, date 30/08/2021

**PËR**

**ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE PER PROMOVIMIN DHE SENSIBILIZIMIN E  
VLERAVE TE SHUMANSHME TE DIGAVE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" si dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në mbledhjen e datës 30.08.2021 mori në shqyrtim propozimin për organizimin e Aktiviteteve të Promovimit dhe Sensibilizimit të vlerave të shumanshme të digave.

Pas shqyrtimit të propozimit në fjale dhe diskutimeve nga të gjithë antaret pjesëmarrës, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha,

**VENDOSI:**

- 1- Të Miratojë Organizimin e aktiviteteve perkatese per promovimin dhe sensibilizimin e vlerave te shumanshme te digave te medha qe perdoren per prodhim hidroenergjie ne vendin tone.
- 2- Keto Aktivitete do te konsistojne ne pregatitjen e paketave fotografike profesionale dhe ne organizimin e nje konkursi per fotografine me te mire profesionale dhe fotografine me te pelqyer nga publiku per te gjitha digat e medha qe perdoren per prodhim hidroenergjie sipas listes bashkelidhur ketij vendimi.
- 3- Keto Aktivitete do te organizohen brenda muajit nendor 2021 ne bashkepunim me Akademin e Shkencave te Shqiperise, Universitetin Politeknik te Tiranës si dhe me shfrytëzuesit e këtyre digave.
- 4- Te gjitha paketat fotografike qe do te dorezohen prane SKDM do te jene pjese e arshives teknike te KKDM dhe do te perdoren per promovimin dhe sensibilizimin e vlerave te digave.

Ngarkohet Kryetari i KKDM dhe Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për zbatimin e këtij Vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

